



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 24 qershor 2013
Nr. ref.:RK428/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI38/13

Parashtrues

Miftar Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë

së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 48/2012, të 13 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Miftar Krasniqi, me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Pkl. nr. 48/2012), të 13 prillit 2012. Parashtruesi nuk ka cekur asnjë datë të pranimit të këtij vendimi.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës; në nenin 47, në nenin 48 dhe në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 28, në rregullin 29 dhe në rregullin 30 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 mars 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 25 mars 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 2 prill 2013, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai t'ia dorëzojë Gjykatës kopjet e aktgjykimeve dhe të vendimeve gjyqësore relevante për rastin e tij.
8. Më 17 prill 2013, parashtruesi i dorëzoi kopjet e aktgjykimeve dhe të vendimeve gjyqësore relevante, siç ishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese.
9. Më 15 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Enver Hasani për të zëvendësuar gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi në Kolegjin shqyrtues. Kështu, Kolegji shqyrtues është i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
10. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

11. Në një datë dhe kohë të pacaktuar, parashtruesi ishte përfshirë në një aksident komunikacioni.
12. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë (P. nr. 431/2007) e dënoi parashtruesin për veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik, dhe e dënoi atë me 6 muaj burgim.
13. Më 31 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (AP. nr. 126/2010) e vërtetoi këtë gjykim dhe këtë dënim.
14. Në një datë të mëvonshme të paspecifikuar, si duket, parashtruesi e kishte kryer një ekspertizë të pavarur përkitazi me rrethanat e fatkeqësisë. Më pas, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjakovë që rasti i tij të rishikohet dhe të rigjykohet bazuar në gjetjet e këtij eksperti të pavarur.
15. Më 10 janar 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë (P. nr. 431/2007) e refuzoi këtë kërkesë.
16. Më 14 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (P. nr. 12/2012) e shpalli ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale.
17. Më 13 prill 2012, Gjykata Supreme (Pkl. nr. 48/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të dorëzuar në emër të parashtruesit.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

18. Parashtruesi pretendon se Gjykata Komunale në Gjakovë, Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e kishin shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi pretendon se ekspertiza në të cilën janë mbështetur gjykatat gjatë gjykimit kishte dështuar të përcaktojë nëse shoferët e ndryshëm të përfshirë në aksidentin e komunikacionit rrugor kishin qenë nën ndikimin e alkoolit, dhe se kjo ekspertizë e mangët kishte çuar në një interpretim të gabuar të rrethanave të aksidentit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke i mohuar atij një rigjykim në bazë të ekspertizës së tij të pavarur, gjykatat kanë shkelur të drejtën e tij për një gjykim të drejtë.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë rast, Gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë të veçantë nëse parashtruesi i ka plotësuar kushtet e nenit 113 (1) të Kushtetutës dhe të nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës.
22. Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:
1. *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
- [...]
7. *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
23. Parashtruesi është palë e autorizuar dhe, si duket, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
24. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:
- “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht[...].”*
25. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës parasheh:
- “Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
- (b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit”.*
26. Gjykata vëren se vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit është Vendimi i Gjykatës Supreme (Pkl. nr. 48/2012), i 13 prillit 2012.
27. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatë më 14 mars 2013. Parashtruesi nuk ka ofruar asnjë informatë përkritazi me datën e pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme.
28. Në këto rrethana, Gjykata vëren se vendimi përfundimtar është ai i datës 13 prill 2012, kurse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 14 mars 2013, që është më shumë se njëmbëdhjetë (11) muaj pas atij vendimi.
29. Gjykata vlerëson se nuk është e arsyeshme të konsiderohet që vendimi i Gjykatës Supreme, i cili ka të bëjë me dënimin penal, nuk i është dorëzuar

parashtruesit deri në një datë, katër muaj para dorëzimit të kërkesës më 14 mars 2013, respektivisht deri më 14 nëntor 2012.

30. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkesa nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore, sepse ajo nuk është dorëzuar brenda afatit katërmujor, të përcaktuar me Ligj dhe me Rregullore të punës, prandaj ajo duhet të hedhet poshtë si e papranueshme pasi që është e paafatshme.
31. Rrjedhimisht, për arsyet e sipërpërmendura, Kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 49 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 24 qershor 2013, njëzëri:


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani